

Prishtinë: 23.11.2006
Kodi i ZRRE-së: D_26_2006
Nr. I Referencës ERO/CPD_D_08_10_06

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e dhëna Zyrës së Rregullatorit për Energji në Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Apelimi i Konsumatorit kundër faturës së KEK-ut e ngarkuar për mbi limit;
4. Përgjigjen e KEK-ut me numër të Referencës DPR – CO1 – 19 të datës 15.06.2006;
5. Apelimi në Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve ("DMK") në Zyrën e Rregullatorit për Energji ("ZRRE") në pajtim me Nenin 14.1 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë me numër regjistrimi 17/11 2006 të datës 02.10.2006;
6. Vendimin e DMK-së lëshuar konsumatorit të datës 16.10.2006
7. Parashtrimi nga ana e konsumatorit të kundërshtimit të vendimit të lëshuar nga DMK e ZRRE-së, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 30.10.2006:

Në seancën e mbajtur më 23.11.2006 morri këtë vendim:

VENDIM

Apelimi i Konsumatorit të Z. Fejzullah Krasniqi kundër Vendimit të DMK **ËSHTË REFUZUAR** për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetimi

1. Më 15.06.2006 konsumatori ka apeluar faturën e tij në KEK për periudhën e shkurtit të vitit 2006 (më 24.02.2006) në vlerë prej 192.79 € për energji, ngarkesën për fuqi 127.20 € dhe mbi limitin për fuqi në vlerë prej 38.56 € të nxjerrë nga KEK-u.
2. Më 20.09.2006 KEK-u iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar apelin e tij sepse çdo lidhje e re në rrjetin elektrik ose për ndërrim i njehsorit duhet të bëjë kërkesë për regjistrim në Shërbimin për Kujdes të konsumatorëve ku në rastin tuaj njehsori është regjistruar pa kërkesë.
3. Më 02.10.2006 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së.

4. Më 16.10.2006 Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) ka refuzuar apelimin e konsumatorit për shkak të këtyre arsytive:
 - 4.1 Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së të datës 02.10.2006 me nr. të ankesës 17/10 2006 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 20.09.2006, e cila përgjigje i është dhënë konsumatorit në lidhje me ankesën e tij me nr. DPR – CO1 – 19 të datës 15.06.2006.
 - 4.2 Konsumatori në kërkesën e tij kërkon lirimin nga pagesa e borxhit të ngarkuar me mbilimit në faturën e tij të periudhës së 2-të (muaji Shkurt) të vitit 2006 të datës 24.02.2006 në vlerë prej 192.79 € për energji, ngarkesën për fuqi 127.20 € dhe mbi limitin për fuqia në vlerë prej 38.56 €.
 - 4.3 KEK-u në përgjigjen e tij ka shpjeguar se fatura të cilën e konteston konsumatori është për periudhën kur konsumatori nuk ka qenë i regjistruar si konsumator i rregullt, andaj fatura ka përfshirë periudhën 4.5 mujore të shpenzimit të konsumatorit nga momenti i vendosjes së njehsorit deri në momentin e leximit të njehsorit nga ekipet inspektuese të KEK-ut. KEK-u nuk ka ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj konsumatorit por vetëm e ka ngarkuar atë për energjinë e konsumuar dhe ka kërkuar nga konsumatori që të aplikoi për regjistrimin të njehsorit të cilën gjë konsumatori e ka bërë me datën 29.03.2006.
 - 4.4 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRE-së, përgjigjen e KEK-u dhënë konsumatorit, dokumentet shtesë të ofruara nga konsumatori dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të aplikueshme në Kosovë, konstaton se përgjigja e KEK-ut dhënë Konsumatorit ishte në pajtim me legjislacionin në fuqi, andaj refuzon ankesën e konsumatorit si të pabazë.
5. Më 30.10.2006 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK në Bordin e ZRRE-së.
6. Më 23.11.2006 Bordi i ZRRE-së ka mbajtur një sesion dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur të refuzoj konsumatorin për shkak të arsytiveve të paraqitura në pikën 4 të Vendimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi konsumatori mund të iniciojë procedurë gjyqi në Gjykatën Komunale në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Kryesuesi i Bordit

Antarët e Bordit:
